



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 42, Datë 11.02.2026

MBI

**RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “INFO-TELECOM” SH.P.K. NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “e”, 5, pika 1, gërma “e”, 13 dhe 16 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.02.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 133/7 prot., datë 10.02.2026, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “INFO-Telecom” sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatohet se:

- Shoqëria “INFO-Telecom” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 147, datë 24.06.2021, me afat licence deri më 24.06.2026.
- Shoqëria ka paraqitur kërkesën për rinovimin e kësaj licence brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të ndryshuar”.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 8, datë 15.01.2026, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 491, Seria T21, të shoqërisë “INFO-telecom” sh.p.k., për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 147, datë 24.06.2021.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 16.01.2026 dhe 17.01.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 26.01.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Gjithashtu njoftimi për fillimin e procedurës u botua në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- ERE, me shkresën nr. 133/2 prot., datë 22.01.2026 dhe e-mailin nr. 133/5 prot., datë 06.02.2026 ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës dhe i ka bërë me dije informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet për këtë aplikim.
- Me shkresat e protokolluara në ERE nr. 133/3 prot., datë 02.02.2026 dhe nr. 133/5 prot., datë 06.02.2026, shoqëria ka depozituar informacionin/dokumentacion e munguar të aplikimit.
- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi, rezulton se shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e nevojshëm për këtë aplikim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të rinovojë licencën nr. 491, Seria T21, të shoqërisë “INFO-Telecom” sh.p.k., për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 147, datë 24.06.2021, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 25.06.2026.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “INFO-Telecom” sh.p.k., OST sh.a., OSSH sh.a. dhe ALPEX sh.a., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI